



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 85, datë 29.12.2016

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË INVENTARIT TË PASURIVE ÇERDHE,
KOPSHTË, SHKOLLA, BIBLOTEKA DHE KINEMA, QË JANË NË JURIDIKSIONIN
TERRITORIAL DHE ADMINISTRATIV TË BASHKISË TIRANË DHE KËRKESËS PËR
TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE**

Në mbështetje pikës 1/1.1, shkronja “b” dhe pikës 1/1.2 të nenit 9, nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); pikës 6 dhe pikës 14, paragrafi i dytë i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); pikës 1, shkronja “a” të Udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës”;

V E N D O S I:

- 1.** Miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pasurive çerdhe, kopshte, shkolla, biblioteka dhe kinema, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë, sipas listës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.** Miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtar të pasurive të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi nga Këshilli i Ministrave.
- 3.** Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit dhe Drejtoria e Pronës së Paluajtshme.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI